



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
SENATI AKADEMIK

Nr. 150/3 prot.

Vlorë, më 01.02.2018

**VENDIM PROPOZUES**

**Nr. 4, datë 01.02.2018**

**PËR NGARKESËN MËSIMORE TË PERSONELIT AKADEMIK**

Mbështetur në pikën 8 të nenit 59, të ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në Udhëzimi nr. 20, datë 09.05.2008 i Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës “Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë” si dhe në propozimin e Rektoratit, shkresa me nr. 142/1 prot., datë 29. 01. 2018, Senati Akademik në mbledhjen e datës 01.02.2018

**V E N D O S I:**

T’i propozojë Bordit të Administrimit të Universitetit “Ismael Qemali”, Vlorë për miratim, si më poshtë:

1. Duke filluar nga viti akademik 2017-2018, për nevoja të institucionit, personeli akademik i Universitetit “Ismael Qemali”, Vlorë, përfshirë dhe autoritetet drejtuese akademike, pasi të ketë plotësuar të gjitha detyrimet e kohës vjetore të punës, 1536 orë, mund të tejkalojë deri në 260 orë mësimore të pagueshme, normën vjetore të mësimdhënies në auditor, shprehur në orë mësimore të konvertuara, sipas pikës 4.2.1 dhe 4.2.2 të Udhëzimit të MASR-së, nr. 20, datë 09.05.2008, “Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë”.
2. Ky vendim propozues i përcillet Bordit të Administrimit për shqyrtim dhe miratim.

**KRYETARI I SENATIT**

**Prof. Dr. Roland Zisi**

